



QKLL 2025

MAJ



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT


ALDA BARDHYLI – DREJTORE E QKLL

PËRGATITI: DR. ANILA VOGLI MAKRI

6 MAJ 2025 / TAKIM ME RASTIN E 620-VJETORIT TË LINDJES SË HEROIT TONË KOMBËTAR GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU



4 SHKURT 2025 / MAKS VELO, IDE TË PANDRYSHUESHME – TAKIM NË PËRKUJTIM TË TIJ



24 MAJ 2025 / MBAHET CEREMONIA E NDARJES SË ÇMIMEVE TË KONKURSIONIT LETRAR TË GEGNISHTES PËR VITIN 2025



2 maj 2025 / Ndahen vlerësimet për fituesit e FONDIT TË KRIJIMTARISË LETRARE PËR TË RINJ PËR VITIN 2025



24 maj 2025 / Çelet në Korçë Festivali Ndërkombëtar i autorëve "NETËT KORÇARE TË POEZISË"



1 maj 2025 / Hapet panairi tregues i librit "KAMZA LEXON"



28 maj 2025 / Me mbështetjen e QKLL botohet libri "VOSKOPOJA DHE BOTA PËRRETH", i autorit PËLLUMB XHUFË





QKLL 2025

MAJ

AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT



6 MAJ 2025 / TAKIM ME RASTIN E 620-VJETORIT TË LINDJES SË HEROIT TONË KOMBËTAR **GJERGJ KASTRIOTI - SKËNDERBEU**



Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit mbajti aktivitetin me temë "Skënderbeu, identiteti dhe bashkëkohësia", në kuadër të 620-vjetorit të lindjes së Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, ku i ftuar ishte historiani i njohur, Pëllumb Xhufi. Gjergj Kastrioti - Skënderbeu është figura më e madhe historike në historinë e popullit shqiptar. I cilësuar si shqiptari më i njohur në botë ndër shekuj, ai nderohet si prijës ushtarak dhe strateg i fortë i

mbrojtjes së interesave të popullit shqiptar. Rëndësia e Skënderbeut në historinë e popullit shqiptar, ndërkaq, nuk është vetëm ushtarake, por edhe politike, shtetkrijuese, diplomatike e qytetëruese. Për shekuj me radhë shërbeu si burim frymëzimi i intelektualëve pasardhës, të cilët luftuan për lirinë dhe formimin e shtetit të pavarur shqiptar. Indro Montanelli gazetari i njohur italian, e quante Skënderbeun si

"poetin e madh të politikës shqiptare". Historiani Pëllumb Xhufi shpalosi në hapësirat e QKLL-së përballë një audience të rinjsh e historianësh, një histori të jashtëzakonshme të Skënderbeut, si një figurë madhore, unifikuese të kombit shqiptar, e cila është një pikë e rëndësishme referimi modelesh për historinë, politikë, kulturën sot.

1 MAJ 2025 / HAPET PANAIRI TREDITOR I LIBRIT **"KAMZA LEXON"**



Sheshi "Nënë Tereza" në Kamëz, u kthye në një hapësirë të bukur libri.

Më datë 1 maj 2025 u çel panairi treditor i librit "Kamza lexon", edicioni i tij i katërt ku pati një shumëllojshmëri aktivitetesh mbi librin, autorin, përkthyesin, botuesin dhe lexuesin e epokës digjitale. Gjatë ditëve të panairit u organizuan takime me autorë të bashkëkohësish, lexime, diskutime,

promovime librash dhe ndarje çmimesh.

Në programin e ditës së parë u zhvillua tema: "Evolucioni i librit të shtypur në epokën digjitale", me moderatore znj. Gilma Bajramaj.

Ky takim mbledhi profesorë, autorë, studiues, botues, shkrimtarë dhe gazetarë të njohur. Diskutimet u fokusuan te libri dhe evolucioni i tij në periudhën digjitale. Ky takim pati



QKLL 2025

MAJ



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

për qëllim që të ftonte për diskutime dhe mendime pjesëmarrësit mbi përfitimet dhe sfidat që sjell epoka digjitale për librat dhe lexuesit. Si ka evoluar libri nga forma e tij tradicionale deri në formatin digjital. Tematikat e përzgjedhura në këtë takim letrarokulturor shërbyen si një platformë për të diskutuar dhe reflektuar mbi rëndësinë e librit dhe ndikimin e tij në shoqëri.

1. Si ka ndryshuar koncepti i librit nga forma tradicionale në atë digjitale.

Impakti i librit në shoqërinë moderne; Cila formë është më efektive tek të rinjtë; Si ndikon forma digjitale në mënyrën si lexojmë dhe përvetësojmë informacionin;

2. Ndikimi i teknologjisë:

Si u zhvilluan platformat si Kindle, e-Books dhe platforma të tjera që janë bërë popullore për leximin; Si

ndikon roli i rrjeteve sociale në promovimin e librave dhe si kanë ndikuar blogjet e letërsisë në krijimin e komunitete lexuesish;

3. Sfidat dhe mundësitë:

Sfida për autorët dhe botuesit, si kanë ndikuar e-book-ët dhe platforma të tjera digjitale në industrinë e botimeve; Mundësitë e reja, si mund të përdoren teknologjitë e reja për të përmirësuar procesin e krijimit dhe shpërndarjes së librit;

4. E ardhmja e librit:

Mundësi të reja, teknologjitë e reja si realiteti virtual dhe interaktiviteti në libra; Si do të duket formati i librit në të ardhmen; Po mundësia e përzierjes së formateve të ndryshme, tekst audio, video, cili është rezultati i pritshëm i ekzistencës së librit;

Me pjesëmarrësit:

• Piro Misha, Drejtor i Bibliotekës Kombëtare Shqipërisë.

• Fatos Kongoli, shkrimtar, gazetar letrar dhe redaktor.

• Alda Bardhyli, Drejtore e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit

• Anila Mullahi, autore, pedagoge në Katedrën e Letërsisë në Universitetin e Tiranës.


• Dhurata Shehri, autore, pedagoge në Katedrën e Letërsisë në Universitetin e Tiranës.

• Edon Qesari, Doktor i shkencave në histori politike dhe sociale, pedagog dhe kërkues shkencor në Institutin e Historisë, Akademia e Shkencave.

• Ben Andoni, gazetar, përkthyes dhe publicist.

• Albert Gjoka, Drejtor "Instituti Kulturë dhe Edukim për Zhvillim themelues i portalit online "Bukinist.al."

• Katerina Kule, gazetare dhe moderatore në Radio Televizionin Shqiptar.



1 MAJ 2025 / THIRRJE PËR APLIKIM NË GJININË E PROZËS DHE POEZISË PËR FËMIJË



Letërsia shqipe për fëmijë, është pjesë e trashëgimisë sonë letrare në edukimin e brezave.

Mbështetja e autorëve që e pasurojnë këtë letërsi, është pjesë e rëndësishme e punës sonë, drejt vazhdimësisë dhe vlerave.

Thirrja u drejtohet autorëve mbi moshën 18 vjeç, në gjininë e prozës dhe poezisë për fëmijë. Aplikimi kryhet nga një botues i pajisur me licencë përkatëse, nëpërmjet përfaqësuesit ligjor.

Shuma e financimit për mbështetjen e procesit krijues të veprës, do t'i paguhet drejtpërdrejt botuesit.

Aplikimi fillon më datë 01.05.2025 dhe përfundon më datë 20.05.2025, ora 16:00.

Aplikimet me dokumentacion të paplotë, nuk do të merren në shqyrtim për fazën përzgjedhëse.



QKLL 2025

MAJ



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

Aplikimet do të dorëzohen në formë të printuar, dorazi ose në rrugë postare, në zyrën e Protokollit të Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit brenda datës 20.05.2025, ora 16:00, në adresën elektronike:

info@qkll.gov.al dhe atë postare: Rruga "Papa Gjon Pali II", nr. 1010, Tiranë, Shqipëri.
Për informacione të mëtejshme, mos ngurroni të na shkruani në: info@qkll.gov.al

2 MAJ 2025 / NDAHEN VLERËSIMET PËR FITUESIT E FONDIT TË KRIJIMTARISË LETRARE PËR TË RINJ PËR VITIN 2025

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit ndau sot vlerësimet për fituesit e Fondit të Krijimtarisë Letrare për të Rinj për vitin 2025. Juria, e kryesuar nga shkrimtari Ylljet Aliçka dhe me anëtarë pedagogen e letërsisë, Dhurata Shehri dhe gazetaren e kulturës, Arta Marku vlerësuan mes 18 dorëshkrimeve veprat: "Pallati i dëshpërimit" (roman), "Testosteron" (vëllim me tregime), "Shpikja e skandalit në idil" (vëllim me poezi). Fituesit e Fondit të Krijimtarisë Letrare për të Rinj për vitin 2025 janë:

Ena Bulku për romanin "Pallati i dëshpërimit", nga shtëpia botuese "Ombra GVG" me motivacionin: "Një roman që eksploron në mënyrë fine fatin e individit, botën e tij të brendshme duke përzier erudicionin, poezinë dhe meditim mbi kohën dhe kujtesën".

Arbër Selmani për vëllimin me tregime "Testosteron", nga shtëpia botuese "Albas" me motivacionin: "Proza që shkëlqejnë me intuitë dhe stil në zbulimin e të vërtetave të artit".

Elvin Nuri për vëllimin poetik "Shpikja e skandalit në idil", nga

motivacionin: "Poezi e vetmisë urbane, që figurën e bën zgjedhje jo dekorative".

Ndërkohë, me propozimin e jurisë do të mbështeten për botim edhe tre të rinj të tjerë, të cilët janë:

Liza Brozi me dorëshkrimin "Vdekja e kukullës" nga shtëpia botuese "Albas".

Antonio Çikollari me dorëshkrimin "Pesë vdekje" nga shtëpia botuese "Albas".

Xhensila Dautllari me dorëshkrimin "Anahera: E fshehta në godinën e pestë" nga shtëpia botuese "Toena".



7 MAJ 2025 / MAKS VELO, IDE TË PANDRYSHUESHME - TAKIM NË PËRKUJTIM TË TIJ



U mbajt në mjediset e Muzeut

Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe" aktiviteti me temë "Maks Velo, ide të pandryshueshme", lexime dhe reflektime. Kritiku i artit, Abaz Hado dhe kuratori Gent Gjikota shpalosën përpara të rinjve të pranishëm në aktivitetin artistin shumë-dimensional Maks Velo, një artist i papërsëritshëm, një mendimtar i guximshëm dhe një zë i lirë në kohëra të vështira.

Figura e Maks Velos, një krijues që nuk ndaloi kurrë së sfiduari kufijtë e artit dhe mendimit u vlerësua edhe nga drejtoresha e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, Alda Bardhyli dhe drejtoresha e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe", Etleva Demollari. Takimi u shoqërua edhe me lexime nga krijimtaria e tij letrare. Aktiviteti u organizua në kuadër të "Viti i Maks Velos" si dhe 5-vjetorit të vdekjes së tij.



QKLL 2025

MAJ



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT



13 MAJ 2025 / THIRRJE PËR PROJEKTE TË PROGRAMIT TË NDIHMËS PËR BOTIM 2025

Jeni botues shqiptar ? Keni projekte botimi të veprave të autorëve të gjuhës frënge në shqip për vitin 2025-2026? Merrni pjesë në thirrjen për projekte të programit të ndihmës për botim 2025!

Data e fundit për dorëzimin e dosjeve është 22 maj 2025, ora 24:00 njëherazi në dy adresat: scac.tirana-amba@diplomatie.gouv.fr dhe info@qkll.gov.al.

Ky projekt është një bashkëpunim i Ambasadës së Francës në Shqipëri me Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit të Shqipërisë (QKLL)

<https://al.ambafrance.org/Thirrje-per-projekte-te...>

Vous êtes éditeur albanais ? Vous avez des projets de publication d'œuvres d'auteurs de langue française en albanais pour 2025-2026 ? Participez à l'appel à projet du programme d'aide à la publication 2025 !

Vous pourriez déposer vos dossiers jusqu'au 22 mai 2025 minuit, aux deux adresses suivantes: scac.tirana-amba@diplomatie.gouv.fr et info@qkll.gov.al

Ce projet est une collaboration de l'Ambassade de France en Albanie avec le Centre national du livre et de la lecture d'Albanie.



14 MAJ 2025 / TAKIM ME PROF. XHAVIT BEQIRI, DOM FATMIR KOLIQI DHE STUDIUESI NDUE UKAJ

U mirëpritën për një vizitë në Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit, profesori Xhavit Beqiri, Don Fatmir Koliqi dhe studiuesi Ndue Ukaj. Raportet me librin mes Kosovës dhe Shqipërisë, roli i mendimit teologjik në një qasje të re ndaj sfidave kulturore sot, biblioteka "Ernest Koliqi" ishin në fokus të një bisede me drejtoreshën e QKLL, Alda Bardhyli.



QKLL 2025

MAJ

AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT



19 MAJ 2025 / JURIA E FONDIT TË PËRKTHIMIT TË LETËRSISË SHQIPE NË GJUHË TË TJERA PËRZGJEDH AUTORËT QË DO TË PËRKTHEHEN

Juria e Fondit të Përkthimit të Librit shqip në gjuhë të huaj, ka vendosur mbështetjen e botimit të librave të mëposhtëm:

1 - Libri “Piramida e shpirtave”, i autorit **Virgil Muçi**, është përkthyer me cilësi në gjuhën serbe. Saktësia dhe besnikëria ndaj tekstit origjinal spikatin. Rrjedhshmëria e gjuhës është e një niveli të tillë, sa që nuk dallohet nëse libri është përkthyer apo është shkruar drejt e në gjuhën pritëse. Kjo vepër dhe ky përkthim e meritojnë plotësisht mbështetjen nga Fondi i Përkthimit letrar.

2 - Romani “Kronikat e mjegullës”, i autorit **Bashkim Hoxha**. Një vepër sfiduese për nga zhanri dhe simbolika, e cila vjen bukur në gjuhën gjermane, duke ruajtur sa më shumë botëkuptimin origjinal, çka i jep mundësinë lexuesit të kultivuar gjerman që të njihet me një vepër të spikatur në letrat shqipe.

Romani “Engjëj të armatosur”, i autores **Diana Çuli**, përkthyer në greqisht

Autorja e mirënjohur, njëherazi përkthyes dhe studiuese e letërsisë shqipe, Diana Çuli, kësaj here përkthehet në greqisht. Teksti i përkthyer përcillet bukur në gjuhën greke, së bashku me të gjithë elementet stilistikore të veprës. Ky roman i drejtohet një lexuesi me shije, që e njeh mirë romanin si zhanër letrar. Dhe vetë autorja zgjon problematika të ndryshme me ngjyrimet shpeshherë filozofike. Botimi i këtij romani në gjuhën greke është një kontribut i rëndësishëm në njohjen e letërsive fqinje ballkanike.

“Poema të zgjedhura” e autorit **Preç Zogaj** është përzgjedhur si një përballje e bukur e kulturës shqipe në atë greke, jo vetëm për peshën që ka autori për letrat shqipe, por për tërësinë e tematikave dhe mënyrën se si vargu i tij përcjell koncepte dhe përfytyrime, të cilat meritojnë që të

shijohen nga një auditor aq i kultivuar me poezinë.

“Sende që nxirrte deti” i autorit **Ardian Vehbiu** është përzgjedhur sërish në gjuhën greke dhe me një përkthim të arrirë, ku gjuha e autorit vjen e fuqishme për të përcjellë perceptimin e Shqipërisë përmes një pene intelektuale. Dhe, tematikat e jetës, të cilat ngjallin kujtesë emocionale të thellë përfshijnë shikime filozofike të individit shqiptar që shijohen bukur. Përcjellja në arabisht e librit “Midis krimeve dhe mirazheve” e autorit **Besnik Mustafaj** është vlerësuar maksimalisht nga eksperti i gjuhës. Juria ka vlerësuar përveç faktit të vlerave të autorit dhe idenë se libri po përcillet në një treg, i cili ka nevojë që të njihet me kulturën tonë. Dhe, cili më mirë mund ta realizonte sesa autori ynë, i cili njihet për thellësinë e vështrimeve dhe mënyrën se si e përcjell paradoksin.



QKLL 2025

MAJ



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT



21 MAJ 2025 / ZGJIDHET JURIA E FONDIT TË KRIJIMTARISË LETRARE PËR FËMIJË

Albert Gjoka, Irena Prici dhe Flori Kasaj do të jenë anëtarët e jurisë së Fondit të Krijimtarisë Letrare për fëmijë. Mbështetja e letërsisë shqipe për fëmijë është e lidhur drejtpërdrejtë me edukimin dhe vazhdimësinë. Çdo vit Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit mbështet 3 autorë shqiptarë që shkruajnë në këtë gjini. Fituesit do të shpallen në muajin qershor, që është konsideruar dhe si muaji i letërsisë për fëmijë.



24 MAJ 2025 / Mbahet ceremonia e ndarjes së çmimeve të KONKURISIT LETRAR TË GEGNISHTES PËR VITIN 2025

Më datë 24 maj 2025 në oborrin e shtëpisë së atdhetarit, profesorit, shkrimtarit, përkthyesit dhe publicistit Sami Repishti, Shkodër u mbajt ceremonia e shpalljes së çmimeve "Ndre Mjeda" – për poezinë më të mirë, "Gjon Shllaku" – për përkthimin më të mirë, "Ernest Koliqi" – për prozën më të mirë, "Arshi Pipa" – për esenë më të mirë dhe "Sami Repishti" – çmim nderi i veçantë për Konkursin Letrar të Gegnishtes për vitin 2025.

Juria me anëtarë Primo Shllaku – shkrimtar dhe përkthyes, Mimoza Hysa – shkrimtare dhe përkthyes, Vlora Ademi – poetë dhe diplomate e kulturës, Lulzim Haziri – publicist dhe gazetar, dhe Meritan Spahia – përkthyes dhe prozator gjykuan që Dr. Gëzim Puka të nderohej me çmimin "Arshi Pipa" – për esenë më të mirë, Artur Baku me çmimin "Ernest Koliqi" – për prozën më të mirë, Agim Morina me çmimin "Gjon Shllaku" – për përkthimin më të mirë, Nurie Emrullai me çmimin "Ndre Mjeda" – për poezinë më të mirë dhe Diana Kastrati me çmimin Sami Repishti".

Mbrëmja u shoqërua me muzikë klasike shqiptare dhe të huaj, e interpretuar nga kuarteti i harqeve – instrumentistë të Orkestrës së Teatrit të Operës dhe Baletit.



QKLL 2025

MAJ



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT



24-25 MAJ 2025 / ÇELET NË KORÇË FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I AUTORËVE "NETËT KORÇARE TË POEZISË"

Më datat 24-25 maj 2025, në qytetin e Korçës u çel Festivali Ndërkombëtar i Autorëve "Netët Korçare të Poezisë" ku morën pjesë autorë shqiptarë dhe të huaj të letërsisë, si: Angela Valenti Durazzo, Bardhosh Gace, Pierre Ech-Ardour, Helena Halilaj, Albin Lushi, Maklena Nika, Sadik Bejko, Raimonda Moisiu - Sade, Tsvika Nir, Entela Kasi, Vlorë Konishevci etj.

Në këtë edicion, marrin pjesë 34 poetë nga Italia, Franca, Izraeli, Monako, Greqia, Kosova dhe Shqipëria, të cilët sollën me vete jo vetëm vargje të frymëzuara, por

edhe tingujt dhe ndjesitë e vendeve të tyre.

Korça, edhe një herë, u shndërrua në një skenë të hapur ku poezia nuk njehej kufij – një udhëtim shpirtëror që na bashkon nëpërmjet gjuhës universale të artit.

Ky festival është shumë më tepër se një ngjarje letrare. Ai është një takim i shpirtit të krijuesit, një dialog i thellë ndërmjet gjuhëve, traditave dhe vizioneve që bashkohen përmes artit të fjalës.

"Këtu, në netët korçare, ne nuk ndajmë vetëm poezi – ne ndajmë përjetime, ndjesi, dhimbje, dashuri dhe shpresë. Në këto netë, fjala nuk

është vetëm mjet shprehjeje, por urë lidhëse mes njerëzve dhe kulturave.

Le të jetë ky edicion një tjetër dëshmi se poezia nuk është e mbyllur në libra – ajo jeton në rrugë, në zëra, në takime si ky. Dhe mbi të gjitha, ajo jeton brenda nesh, sa herë që zgjedhim të dëgjojmë me zemër, u shpreh në fjalën e saj Drejtorja e QKLL- së, Alda Bardhyli.

Festivali u organizua me mbështetjen e Bibliotekës Publike "Thimi Mitko" Korçë, Bashkisë Korçë dhe PEN Albania.

NDAHEN ÇMIMET NË EDICIONIN E 29-TË TË NETËVE KORÇARE TË POEZISË

Korça u kthye këtë fundjavë në kryeqendrën e poezisë bashkëkohore, me nisjen e edicionit të 29-të të Netëve Korçare të Poezisë, një festival ndërkombëtar që mbledh autorë dhe poetë nga vende të ndryshme të botës.

Në këtë edicion morën pjesë 34 poetë nga Italia, Franca, Izraeli, Monako, Greqia, Kosova dhe Shqipëria, të cilët sollën me vete jo vetëm vargje të frymëzuara, por edhe tingujt dhe ndjesitë e vendeve të tyre.

Poeti Laureat i festivalit u shpall **Sadik Bejko**, i cili mbolli pemën tradicionale në Parkun e poezisë, një akt

simbolik në nderim të trashëgimisë së fjalës së shkruar.

Çmimi Kurora e Poezisë shkoi për poeten **Maklena Nika** me motivacionin: "Për vlerat e qenësishme të krijimit poetik që kanë lartësuar emrin e letërsisë shqipe brenda dhe jashtë vendit.

Çmimi Poezia më e Bukur iu dha poetit **Tsvika Nir** (Izrael) me motivacionin: Për ndjeshmërinë dhe nuancat estetike që u përçuan plot emocion dhe përjetim në veprimtarinë "Netët korçare të poezisë 2022".



QKLL 2025

MAJ



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

Çmimi Dritëro Agolli iu dha poetit **Dinos Kubatis** (Greqi) me motivacionin: “Për poetikën kuptimplotë dhe plot figuracion, të gërshetuar me elementet e letërsisë sonë bashkëkohore”.

Çmimi Asdreni shkoi për poetin **Zyhdi Dervishi** me motivacionin: “Për linjën poetike që përkon me vlerat tradicionale dhe atdhetare në letërsinë shqipe”.

Çmimi Special shkoi për poeten **Rakela Zoga** me motivacionin: “Për këndvështrimin origjinal, për përcjelljen e vlerave universale përmes kumtit poetik.



28 MAJ 2025 / ME MBËSHTETJEN E QKLL BOTOHET LIBRI “VOSKOPOJA DHE BOTA PËRRETH”, I AUTORIT PËLLUMB XHUFË

“Voskopja dhe bota përreth” (Një histori e dokumentuar) shkruar nga historiani i njohur, prof. Pëllumb Xhufi, botuar nga Shtëpia Botuese “Dituria”, vjen për lexuesin 15 vjet pas botimit të parë të titulluar “Shekulli i Voskopojës”. Tani, në botimin e dytë, libri është një vëllim i përpunuar thellësisht dhe i zgjeruar me materiale të shumta, që përbëjnë më tepër se 200 faqe të reja. Një studim i ri, ndërmarrë nga historiani Pëllumb Xhufi në kuadër të ambicies së tij profesionale

për të vënë mbi baza solide shkencore historinë e një qyteti që, si rrallëherë, është shënjestruar për ta dehistorizuar e për ta kthyer në një ikonë të mitologjisë nacionaliste. Botimi i këtij libri është mbështetur nga Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit.





QKLL 2025

MAJ



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

29 MAJ 2025 / PËRURONEN VEPRAT FITUESE NGA “FONDI I PËRKTHIMIT LETRAR NGA GJUHA E HUAJ NË GJUHËN SHQIPE”



U përuruan në ambientet e Librari Adrion libri mbështetjen e Ambasadës së “Mandarinët”, një nga Francës në Shqipëri dhe Qendrës veprat më të Kombëtare të Librit dhe Leximit të rëndësishme të Simone de Beauvoir, i cili pasqyron me një këndvështrim të mpërthtë analitik shoqërinë intelektuale parizienne në fund të Luftës së Dytë Botërore.

Libri vjen në shqip nën përkthimin e Diana Çulit, botuar nga Shtëpia Botuese “Dituria”. Ky libër është botuar me mbështetjen e Ambasadës së Francës në Shqipëri dhe Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit të Shqipërisë përmes programit të ndihmës për botim.

Thirrja për projekte të programit të ndihmës për botim të veprave të autorëve të gjuhës frënge në shqip vijon të jetë e hapur edhe këtë vit. Data e fundit për dorëzimin e dosjeve është 3 qershor 2025, ora 12:00 njëherazi në dy adresat: scac.tirana-amba@diplomatie.gouv.fr dhe info@qkll.gov.al.

